



Gjatë Ramazanit muslimanët e gjith botës fillojnë një kohë përplot adhurime. Kjo kohë përbëhet nga agjërimi, namazi, pendimi, kontrolli i vetes dhe disiplina.

Këto adhurime dhe adhurimet tjera bëhen për të pastruar shpirtin dhe për të arritur Mëshirën dhe shpërblimet e Allahut, subhanehu ve teala. Ramazani është muaji i nëntë i kalendarit hënor. Është muaj i shenjtë kur Fjala e Allahut, Kur'ani Famëllartë filloi t'i shpallet Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, për herë të parë rreth vitit 610 të erës sonë.

Muslimanët kanë agjëruar muajin e Ramazanit për më shumë se 14 shekuj, që nga koha kur Allahu i Madhëruar i ka urdhëruar nëpërmjet Kur'anit të Shenjtë:

O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm. (Bekare: 183)

Ky ajet na tregon qartë se muslimanët nuk kanë qenë të parët që kanë agjëruar. Allahu ua ka urdhëruar agjërimin shumë popujve para ardhjes së Muhammedit, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, si Pejgamber. Kur'ani na tregon se kur Zekeriai alejhis-selam ka lutur Allahun t'i falë fëmijë, Allahu, subhanehu ve teala, e ka urdhëruar atë të agjërojë tri ditë - duke mos folur asnjë fjalë.

Ngjashëm, Merjemja alejhas-selam, nëna e Isait alejhis-selam, poashtu ishte urdhëruar nga Allahu që të agjërojë në të njëjtën mënyrë kur ka mbetur shtatëzëne. Muhammedi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, na ka treguar se Davudi alejhis-selam, ka agjëruar çdo të dytën ditë. Tregohet edhe se Isai alejhis-selam ka agjëruar 40 ditë dhe 40 netë.

Agjërimi çdoherë ka qenë praktikë e njerëzve të devotshëm. Në Islam, agjërimi është një nga shtyllat kryesore, dhe ka karakteristika të larta morale dhe shpirtërore. Shtyllat tjera kryesore janë: Dëshmia se nuk ka zot që meriton të adhurohet përveç Allahut, subhanehu ve teala, dhe se Muhammedi, sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem, është i Dërguari i Tij, Namazi pesë herë në ditë, Zekati (që është 2.5 përqind e pasurisë t'ju jepet njëherë në vit, të varfërve dhe nevojtarëve) dhe Haxhxi në Mekke, njëherë gjatë jetës së njeriut, për atë që ka mundësi fizike dhe financiare.

Këto obligime fetare janë stacione ku besimtari e mbush shpirtin e tij me dashuri ndaj Allahut, subhanehu ve teala, dhe dëshirë për drejtësi. Ashtu siç e ushqejmë trupin tonë me ushqim dhe pije në kohë të ndryshme gjatë ditës, njëjtë, 5 herë në ditë e ushqejmë shpirtin tonë me namaz. Të njëjtën e bëjmë edhe gjatë namazit të Xhumasë, kur kryejmë Haxhxin, dhe kur agjërojmë muajin e Ramazanit, njëherë në vit.

ÇKA ËSHTË AGJËRIMI?

Agjërim do të thotë, durim i plotë nga ngrënia, pirja dhe marrëdhëniet intime prej para agimit të ditës e deri në perëndim të diellit. Agjërim është edhe largim nga kryerja e veprave të këqija, qoftë të vogla apo të mëdha. Kjo nuk do të thotë se agjërimi nuk mund të bëhet edhe në kohë të

tjera gjatë vitit. Në çfarëdo kohe në përgjithësi, nga agjërimi fitohen shpërblime të mëdha, por në këtë muaj agjërimi është urdhër i Allahut, subhanehu ve teala, që duhet të plotësohet nga çdo musliman që ka arritur pjekurinë dhe kuptohet, që ka mundësi fizike të agjërojë.

Ata që nuk mund të agjërojnë për këto shkaqe dhe shkaqe të tjera, mund të hanë dhe pijnë, por ata ende duhet ta kontrollojnë veten dhe mos të bëjnë mëkate. Gjatë Ramazanit edhe ata e përjetojnë dhe e ndajnë përvojën shpirtërore me muslimanët tjerë.

AGJËRIMI ËSHTË SHOLLË PRAKTIKE

Gjatë Ramazanit, besimtarët e mësojnë rregullën e dashurisë së sinqertë. Agjërimi poashtu e pajis njeriun me shpresë të madhe në Zot. Ai e mbush njeriun me devotshmëri, nënshtrim të sinqertë dhe e afron më afër Allahut. Agjërimi mëson njeriun në durim dhe zemërgjërësi. Agjërimi poashtu është një mësim i mirë për të përforcuar modestinë dhe vullnetin. Ai e ngrit shpirtin, e pastron mendjen që të mendojë më mirë dhe më pastër, dhe e lehtëson trupin të lëvizë dhe të veprojë më mirë. Agjërimi krijon një barazi dhe bashkim me agjëruesit tjerë, ai na mëson të kursejmë me mençuri e jo të harxhojmë pa masë. Vërtetë, agjërimi është një shkollë e mrekullueshme për të mësuar drejtësinë, disiplinën dhe vetkontrollin.

AGJËRIMI DHE PËRVOJA SHPIRTËRORE

Agjërimi në muajin Ramazan është një përvojë e mrekullueshme shpirtërore. Ai është një rast për të fituar disiplinë shpirtërore dhe për të

shpërthur falenderim Allahut, subhanehu ve teala, për bekimet dhe udhëzimet e shumta. Është një rast që të tregohet nënshtrimi ndaj Allahut Fuqiptotë. Ramazani është muaj i mëshirës, tolerancës, faljes dhe pastrimit nga gabimet dhe mëkatet. Është një rikujtues se sa i dobët është njeriu dhe sa varet nga Allahu, subhanehu ve teala, Ramazani ua hap sytë besimtarëve që të shohin se çka përjetojnë çdo ditë, të varfërit dhe të uriturit.

AGJËRIMI DHE VËTËKONTROLLI

Për 11 muaj, muslimanët hanë dhe pijnë sa duhet, siç kërkon Islami, por gjatë muajit të Ramazanit ata ripërtrijnë vetëkontrollin dhe fillojnë t'ju përmbahen dëshirave të tyre. Njeriu që agjëron, duhet të tejkalojë urinë dhe etjen dhe duhet t'i mbajë nën kontroll të gjitha dëshirat e tij. Shumë mëkate dhe krime ndodhin për shkak se disa njerëz nuk mund t'i kontrollojnë dëshirat e tyre, qofshin trupore apo mendore. Mëkatarët zakonisht janë njerëz që janë të dobët para dëshirave dhe epsheve të tyre. Shkolla e Ramazanit ua mëson agjëruesve mënyrën më të mirë për t'i tejkaluar dëshirat dhe epsheet e tyre - duke filluar nga më të voglat e deri të ato më të mëdhatë.

AGJËRIMI DHE SHËNDETI

E dimë se qeniet njerëzore janë trupa dhe shpirta. Përderisa agjërimi pastron shpirtin, ai pastron edhe trupin. Agjërimi është shumë i dobishëm për shëndetin. Ai i mundëson lukthit dhe sistemit të tretjes të pushojë. Mjekët zakonisht u thonë pacientëve që të pakësojnë ose kufizojnë ushqimet. Agjërimi zvogëlon yndyrën dhe energjinë e tepërt të mbledhur në trup dhe

kështu çon në humbje të peshës. Agjërimi është mbrojtje e mrekullueshme e barkut dhe zorrëve. Mjekësia moderne ka dëshmuar se agjërimi është shërimi më i mirë për disa sëmundje të barkut.

Ramazani është muaj i të mirave të mëdha, të vendosim ta shfrytëzojmë çdo moment të këtij muaji të madh në gjëra që na afrojnë drejt Zotit, qoftë plotësimin e agjërimin, faljen e namazit me xhemat në xhami, faljen e namazit të natës pa mërzi, leximin e Kur'anit, kujdesin për prindërit dhe farefisën, dhënien e sadakasë, dhe me shumë vepra tjera të mira.

Allahu na i faltë gabimet e kaluara në këtë muaj të bekuar dhe na dhashtë vullnet dhe fuqi që të agjërojmë si duhet.

Përgatiti: Klubi Studentor - Shkup

Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën. Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.

Boton:

Shoqata Qytetare

Klubi Studentor

E-mail: penastudentore@hotmail.com



**Muaji i Ramazanit
dhe agjërimi**